



Pranuar / Dostezuar Primito / Prodato Received / Deliverty	01. 02 2021	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix
SKRM/HCW 410/2021		Sasia Kolicina Quantity 1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.28/2021

**Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga:** Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.28/2021 të datës 26.01.2021, të parashtruar nga ankuesja [ ] në cilën me autorizim e përfaqëson Avokat [ ] me adresë rruga "Afrim Zhitia" pa numër në Mitrovicë, kundër organit të punësimit/Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë "Dr. Sami Haxhibeqiri", në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.02.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.28/2021 e datës 26.01.2021 e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja [ ] përmes përfaqësuesit të saj, më datë 24.01.2021 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 26.01.2021 dhe është protokolluar më Nr. Port: 298/2021, me pretendimet ankimore për harmonizim të koeficientit.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoli 298/2021 e datës 26.01.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 22.01.2021; Kërkesën për ngritje të koeficientit e datës 17.09.2020; Vendimin e datës 02.11.2020 nga Këshilli Drejtues i Spitalit të Mitrovicës; Ankesë e datës 12.11.2020 e parashtruar në Komisionin e Ankesave; Njoftim i datës 22.12.2020 nga Kryesuesi i Komisionit të Ankesave në Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar provave të lëndës, konstaton se ankuesja është në marrëdhënie punë në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës respektivisht në Spitalin e Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" në Mitrovicë në pozitën "Administratore në SISH".

Duke ju referuar Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, respektivisht nenit 62 paragrafit 6, përcaktohet që : ***"Të punësuarit në SHSKUK nuk i takojnë shërbimit civil të Kosovës"***, rrjedhimisht të punësuar në fushën e shëndetësisë në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë janë kategorizuar si nëpunës të shërbimit publik siç përcaktohet me nenin 2 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2, ndërsa lidhur me këtë paragrafi 4 i nenit 2 të këtij ligji, përcakton që: ***"Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike"***.

Ndërlidhur me këtë pjesa V e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësve të shërbimit publik, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: ***"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"***.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A.nr.28/2021, datë 01.02.2021

Sabile AVDYLLI

*Sabile Avdylli*  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit të Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

